



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 578 Prot.

Tiranë, më datë 26.12.2018

VENDIM

Nr. 496, datë 26.12.2018

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT ZHVILLIMOR

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48, pika 1 dhe neni 134, pika 1, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 26.12.2018, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit: “Ndërtimi i HEC Bushtrica 1, në lumin Shkumbin, fshati Qukës, Bashkia Prrenjas, Qarku Elbasan”, kërkesë e “ELENERGJI” sh.p.k.;
- *Shoqëria të kontribuojë për restaurimin pjesor të objektit monument kulture: “Kalaja e Peqinit”*
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 144, neni 145 dhe neni 146;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I KKR

Arta Dollani

KRYETAR

Mirela KUMBARO FURXHI

